



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TË LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

AN231220230004

Tiranë, më 02.05.2024

Komisioni 55

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 828, datë: 28.12.2023, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: “Vellezerit Hazisllari & Qamo (V.H&Q)” Sh.p.k

Nr. NIPT-i: L38927401R

Adresa e selisë: Gjerbës, Objekti Melovë, Zona Minerale Nr.1656, Berat.

Personi përgjegjës: Gëzim Hazisllari

Për të zhvilluar projektin “**SHFRYTËZIM I MINERALIT GURË GËLQEOR, NË SIPËRFAQEN ME KOORDINATA TË ZGJERUARA**”.

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Leja Minerare Nr.1656/1, Objekti “Melovë”, Skrapar.

Të dhëna teknike:

Mbështetur në deklaratimet e AKBN-së

Sipërfaqja që do të preket nga aktiviteti minerar për 25 vite: 3.74 ha.

Lloji i mineralit: *gur gëlqeror*

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit).

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen: Referuar kërkesës së subjektit “Vëllezrit Hazisllari” shpk me nr. AN231220230004 aplikimi, datë 23/12/2023 në lidhje me kërkesën për Deklaratë Mjedisore për procedurën e thelluar të VNM-së për projektin “Shfrytëzim i gurit gëlqeror në sipërfaqe”, me vendndodhje në Melovë, Bashkia Skrapar, bazuar në pikën 11, të Kreut II, të VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, *drejtoritë teknike të ministrisë* shprehin mendimin si më poshtë vijon:
o Sugjerojmë që gjatë zbatimit të projektit, mbetjet e gjeneruara të menaxhohen sipas kuadrit ligjor si më poshtë:

- Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;
- Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, date 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
- Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”;
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar;
- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar;
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B , si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve“ i ndryshuar;
- Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas Parimit të Përgjegjshmërisë Ndaj Mjedisit, në përputhje të plotë me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin në mënyrë të integruar të mbetjeve.

Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjisllacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së shfrytëzimit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;

- Të spërkatën rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;

- Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;

- Me qëllim mbrojtjen e mjedisit, përdorimi i lëndëve plasëse, të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.

o Në zbatim të legjisllacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.

o Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve shprehet si më poshtë.

- Sektori i pyjeve: Vlerësojnë se nëse sipërfaqet që do përdoren për projektin janë me funksion pyll/kullotë, në çdo rast duhet pasur parasysh zbatimi me rigorizitet i ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet” në mënyrë të veçantë neni 12, i tij dhe ligjin nr.9693 datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”. Të realizohet rehabilitimi sipas objekteve dhe parashikimeve ligjore, gjithashtu ka paqartësi në dokumentacionin e konsultimit me publikun, sidomos lidhur me diskutimet për largësinë nga banesat e komunitetit të fshatit.

Drejtoria e natyrës dhe pyjeve shprehet si më poshtë:

Sektori i mbrojtjes së natyrës sugjeron që: subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjisllacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve:

- Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar;

- Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar, si dhe të bëjë rehabilitimin e zonës me mbjellje pemësh.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr.10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve etj., të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti: “Shfrytëzimi i mineralit gurë gëlqeror, në sipërfaqen me koordinata të zgjeruara Leja minerare Nr.1656/1, Objekti «Melovë», Skrapar, me zhvillues dhe aplikues “Vëllezërit Hazisllari Qamo (V. HQ)”, me nr. Aplikimi AN231220230004, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: Në vijim të aplikimit të depozituar në sistemin elektronik të lejeve, me Nr. aplikimi Nr. AN231220230004, për të cilin keni kërkuar mendim për VNM-në e thelluar për Deklaratë Mjedisore, me subjekt zhvillues shoqëria “Vëllezërit Hazisllari Qamo” sh.p.k., ju bëjmë me dije se: Shoqëria “Vëllezërit Hazisllari Qamo” sh.p.k., është njoftuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (shkresa Nr.894/3 Prot, datë 05.04.2023), për të aplikuar në QKB për zgjerimin e sipërfaqes të lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1656, datë 16.08.2013, minerali Gur Gëlqeror, objekti “Mëlovë”, Bashkia Skrapar, Qarku Berat.

Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit Nr. 10 304 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shprehemi dakord për vazhdimin e procedurave për pajisjen e shoqërisë së mësipërme me lejen përkatëse në funksion të veprimtarisë minerare në zonën e licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Bashkia Skrapar shprehet: Pranë Bashkisë Skrapar, më datë 20.02.2024, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, në rolin institucion mendim dhënës është ri paraqitur kërkesa nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. AN231220230004, datë 23.12.2023, "VNM e thelluar për Deklaratë Mjedisore", për subjektin “VËLLEZËRIT HAZISLLARI & QAMO”, për aktivitetin: “Shfrytëzim i gurit gëlqeror, në sipërfaqen me koordinata të ndryshuara, leja minerare nr.1656/1, datë, 21.06.2013, objekti Mëlovë, Skrapar, Qarku Berat”.

Në përgjigje të shkresës suaj, datë 08.02.2024, Komisioni 17, me lëndë: “Kërkohet plotësim informacioni për zhvilluesin “VËLLEZËRIT HAZISLLARI & QAMO” sh.p.k, ju informojmë si më poshtë vijon: Nga verifikimi i kryer nga Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor, për sipërfaqen prej 0.466 km² , sipas lejes minerare nr. 1656, datë, 16.08.2013, për të cilën subjekti “VËLLEZËRIT HAZISLLARI & QAMO” sh.p.k, kërkon të zgjerojë aktivitetin: “Shfrytëzim i gurit gëlqeror, në sipërfaqen me koordinata të ndryshuara, leja minerare nr.1656/1, datë, 21.06.2013, objekti Mëlovë, Skrapar, Qarku Berat”, rezulton se kjo sipërfaqe, ndodhet në:

- ngastrat pyjore nr. 1 dhe nr. 2, të ekonomisë pyjore “Dëvri-Tërrovë”,
- ngastrën kullosore nr.1, të ekonomisë kullosore “Dëvri-Tërrovë”,
- ngastrën pyjore nr. 131, të ekonomisë pyjore, “Dobrenj-Gjokovicë”

Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehet: Nisur nga dokumentacioni i ardhur, ARM Berat-Elbasan-Korçë shprehet parimisht dakord për vazhdimin e procedurave për pajisje me Deklaratë Mjedisore dhe njëkohesisht është e mendimit që komisioni i VNM gjatë shqyrtimit të kërkesës së subjektit zhvillues të marrë parasysh edhe disa kushte të sugjeruara nga ana jone:

1. Lagia e sheshit të ndërtimit, rrugës dhe makinave me ujë për shmangien e pluhurave sidomos gjatë kohës së thatë dhe me erë.
2. Respektimin e normave të shkarkimeve në ajër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Mbetjet inerte që do të gjenerohen të menaxhohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
4. Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licensë III.2.B, në bazë të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar;
5. Subjekti të kontaktojë me pushtetin vendor për largimin e mbetjeve inerte që do gjenerohen gjatë fazes së punimeve në sipërfaqe.
6. Të zbatohet Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar;
7. Kontrollin e dherave të gjeneruara dhe mbeturinave jashtë standartit dhe sistemit të tyre.
8. Të kushtohet rëndësi e veçantë rehabilitimit të peizazhit në të gjithë gjurmën e projektit
9. Kontrolli i makinerive për ndonjë avari të mundshme dhe rrjedhje aksidentale.
10. Kujdes maksimal gjatë punimeve pranë kanaleve apo burimeve ujore në zonë.
11. Subjekti të marrë masa lidhur me trajtimin e ujerave të ndotur nëse ka dhe ujerave të zeza duke instaluar sistemin e trajtimit ose grumbullimin e tyre në gropa septike dhe pastrimin/largimin e llumrave nga gropa septike.
12. Marrjen e masave të mbrojtjes kundër zjarrit dhe pajisjen me sistemin e ujit dhe fikeve të zjarrit në rast të ndonjë aksidenti të mundshëm.

13. Të zbatohen nivelet kufi të zhurmave, referuar Udhezimit Nr.8, date 27.11.2007 ‘Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara’ dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 ‘Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis’.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: U krye në datën 20.12.2023. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor, nga Drejtoria Pyjore, si dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve. Kërkesat e pjesëmarrësve, do të mbahen parasysh, në fazën kur shoqëria do të fillojë procedurat për fazën e shfrytëzimit.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 55, datë 02.05.2024, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.82, datë 02.05.2024, me nr.4934 prot, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;
- Njoftimin për fillim procedure për Zgjerimin e Lejes Nr.1656, datë 16.08.2013, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Mendimin e Bashkisë Skrapar;
- Mendimin e Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise.
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.

4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.

4.4 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë. Të ketë në vëmendje të veçantë referencat kadastrale që preken nga ushtrimi i aktivitetit.

4.5 Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”, nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohen zona me status të vecantë.

Gjatë fazës së instalimit:

- 4.6** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.7** Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.8** Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.9** Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.10** Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.11** Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.12** Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimi të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13** Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në ARM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14** Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.
- 4.15** Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.16** Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17** Subjekti ka detyrimin e menaxhimit të mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara të pajisura me Kod Unik.
- 4.18** Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.19** Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.20** Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.21** Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.
- 4.22** Personi përgjegjës teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve në fuqi dhe për zbatimin e tyre.
- 4.23** Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.24** Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.25** Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.26** Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.

4.27 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	04.11.2024	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	04.11.2024	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	04.11.2024	Çdo 6 muaj

Tabela e niveleve kufi:

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	04.11.2024	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	04.11.2024	Çdo 6 muaj

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	04.11.2024	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve.
- Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara, të pajisura me Kod Unik.
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto

Afati i Vlefshmërisë

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI


MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Harta me Koordinatat (sipas AKBN)



HARTA TOPOGRAFIKE ME KUFIJTE E LEJES NR. 1656 NE
PLANIN E REHABILITIMIT, OBJEKTI "MELOVE", SKRAPAR
Shk 1: 25 000

